REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:173184
Datë: 22.02.2021
Numri i dokumentit: 01527639
PKR.nr.715/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i Trupit Gjykues Kushtrim Shyti, me bashkëpunëtoren profesionale Kristina Shtufi, në çështjen penale kundër të pandehurit Xh. A., i akuzuar për veprën penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.4339/17 dt.10.04.2018, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar në prezencën e palëve: prokurorit të shtetit në PTH në Prishtinë Javorka Prlincevic, të pandehurit dhe përkthyesi gjyqësor Sadik Osmani. Gjykata pas përfundimit të shqyrtimit fillestar me datë 15.02.2021, të njëjtën ditë e ka shpallur publikisht, ndërsa me datë 22.02.2021, është përpiluar me shkrim ky:

A K T GJ Y K I M

Kundër të pandehurit:
Xh. A., nga i ati P., e ëma H., e vajzërisë B., i lindur më dt: ..., me adresë të vendbanimit rr.”...” nr..., ..., në P..., ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë-veteran lufte, i martuar, baba i ..., fëmijëve, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i njëjti;

SHPALLET FAJTOR

SEPSE:
Me datë 12.06.2017, rreth orës 22:36, i pandehuri Xh. A., në rr.”...” pa numër, në Prishtinë, gjatë një ahengu familjarë, e kishte përdorur me vringëllim duke shtënë në ajër me armën-pushkën automatike, të cilën e kishte mbajtur pa leje përkatëse të organit kompetent e në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ashtu që pas kontrollimit të vendit të ngjarjes nga ana e policisë ishte konfiskuar arma-Kallashnikov, ngjyrë e zezë, të tipit AK-47 me nr. serik 011845, një (1) karikator të zbrazët, nëntë plumba të kalibrit 7.62mm, (6) gëzhoja 7.62 të kalibrit mm, si dhe në rrugën kryesore afër shtëpisë ishin gjetur dhe konfiskuar 6 gëzhoja të zbrazëta të kalibrit 7.62 dhe një fotrollë ngjyrë e gjelbër.

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

2019:173185

Gjykata në mbështetje të nenit 1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 22, 41, 42, 43, 45, 46, 62, 73, 74, dhe nenit 374 par.1 të KPRK-ës, e lidhur me nenet 365 dhe 366 të KPP-së, të pandehurit i;

S H Q I P T O N

I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 350€ (treqind e pesëdhjetë euro), të cilën dënim-gjobë obligohet ta paguaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. I njëjti dënimin e shqiptuar mund të paguajë, me dy këste më së largu deri me datën 5 të muajit vijues. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë. Në rast se i pandehuri nuk e paguan këtë gjobë, atëherë e njëjta do të zëvendësohet me dënim me burgim, siç përcaktohet me nenin 46 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke ju llogaritur një ditë burgim ekuivalent me 20€ (njëzet euro) dënim me gjobë.

II. Obligohet i pandehuri të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, si dhe shumën prej 50 euro në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, në tërësi shumë prej 70 (shtatëdhjetë) euro, të gjitha obligohet t'i paguaj në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. DËNIM PLOTËSUES- Marrja e sendeve. Gjykata, në mbështetje të nenit 282 par.1 e 2 të KPP-së, si dhe neneve 62 par.2.6 dhe 374 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të pandehurit i shqipton dënimin plotësues, ashtu që nxjerrë këtë: URDHËR - URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i sendeve si në vijim: arma-Kallashnikov, ngjyrë e zezë, të tipit AK-47 me nr. serik 011845, një (1) karikator të zbrazët, nëntë plumba të kalibrit 7.62mm, (6) gëzhoja 7.62 të kalibrit mm, si dhe 6 gëzhoja të zbrazëta të kalibrit 7.62 dhe një fotrollë ngjyrë e gjelbër.

IV. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, kjo arma-Kallashnikov, ngjyrë e zezë, të tipit AK-47 me nr. serik 011845, një (1) karikator të zbrazët, nëntë plumba të kalibrit 7.62mm, (6) gëzhoja 7.62 të kalibrit mm, si dhe 6 gëzhoja të zbrazëta të kalibrit 7.62 dhe një fotrollë ngjyrë e gjelbër, duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Prishtinë, pasi që të vërtetohet se kjo armë nuk është përdorur në ndonjë krim tjetër.

V. Kërkesë pasurore-juridike nuk kishte.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.4339/17 dt.10.04.2018 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ndaj të pandehurit Xh. A., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Me datën 15.02.2021, Gjykata për këtë lëndë penale në kuadër të kompetencës lëndore e territoriale, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar. Seanca është mbajtur

2019:173185

në prezencën e palëve: Prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë Javorka Prlincevic, të pandehurit Xh. A., dhe përkthyesit gjyqësorë Sadik Osmani.

I pandehuri Xh. A., në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 15.02.2021, pas njoftimit nga Gjykata lidhur me të drejtat e tij për në këtë fazë të procedurës penale, dhe pasi që u konfirmua se i njëjti i kupton këto të drejta, i pandehuri është deklaruar se e pranon në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata, ka marrë mendimin e palëve në lidhje me deklarimin mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe atë nga prokurorja e rastit Javorja Prlincevic, e cila ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga i pandehuri Xh. A., për veprën penale për të cilën është akuzuar sipas PTHP në Prishtinë me numër PP.II.nr.4339/17, dt.10.04.2018. duke i propozuar gjykatës pasi e njëjta është në harmoni me ligjin, të njëjtën ta pranoni, sa i përket caktimit të llojit dhe lartësisë dënimit që përveç provave të propozuara në aktakuzë gjykata të merr parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e sotëm të fajësisë nga ana e të pandehurit.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri Xh. A., në mbështetje të nenit 248 par.4 të KPP-së, në këtë drejtim ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, gjen se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë dhe se të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese e që në bazë të tyre dhe pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i njëjti ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata, gjen se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare dhe se ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Gjykata i kishte tërhequr vërejtjen të pandehurit se pas pranimit të fajësisë nuk mundet të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësin e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësin për paraqitjen e provave të tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë.

Gjykata ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë prej të pandehurit dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimit ka vërtetuar se i pandehuri Xh. A., është i përgjegjshëm dhe përgjegjës (fajtor) për veprën penale për të cilën akuzohet.

- *Konfiskimi:*

Gjykata në mbështetje të nenit 282 par.1 dhe 2 të KPP-së, dhe neneve 62 par.2.6 dhe 374 par.3 KPRK-së, ndaj të pandehurit ka shqiptuar edhe dënimin plotësues ashtu që ndaj të pandehurit

2019:173185

Xh. A., ka urdhëruar konfiskimin e detyrueshëm e të përhershëm të armës: arma-Kallashnikov, ngjyrë e zezë, të tipit AK-47 me nr. serik 011845, një (1) karikator të zbrazët, nëntë plumba të kalibrit 7.62mm, (6) gëzhoja 7.62 të kalibrit mm, 6 gëzhoja të zbrazëta të kalibrit 7.62 dhe një fotrollë ngjyrë e gjelbër. Gjykata rikujton se i pandehuri se nuk kishte leje e as autorizim për posedimin e armës. Në anën tjetër sendet e lartcekura bëjnë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyrë automatike nga këto arsye gjykata ka vendosur t'i konfiskoj përherë dhe të njëjtat ka urdhëruar që të shkatërrohen. Gjykata vlerëson se në këtë rast plotësohen kushtet ligjore për konfiskimin e përhershëm të armës sipas nenit 374 par.3 KPRK-ës, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm, konfiskimi ishte propozuar në aktakuzë dispozita e lartcekur e këtij Kodi, përcakton shprehimisht konfiskimin e detyrueshëm të tij.

- *Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:*

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, për të pandehurin Xh. A., ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPRK-së, e si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar, dashjen direkte të pandehurit për këtë vepër penale, shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të tij në këtë vepër penale, faktin se kjo natyrë e veprës penale është më e shpeshtuara në Kosovë dhe rrezikshmërinë që paraqet kjo vepër penale.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese ka marrë për bazë faktin se i njëjti ka treguar sjellje të mira dhe paraqitje serioze në gjykatë në raport me gjykatën dhe palët dhe faktin se i pandehuri Xh. A., më parë nuk ka qenë i dënuar dhe se ndaj tij nuk evidentohet se zhvillohet procedurë për ndonjë vepër të tjetër penale. Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin është vlerësuar pranimi i fajësisë në tërësi për veprën penale që akuzohet.

Gjykata vlerëson se një dënim i tillë i shqiptuar ndaj të pandehurit Xh. A., në raport me shkallën e përgjegjësisë, rrezikshmërinë e veprës penale, moshën e të pandehurit dhe rrethanat e tjera që i kemi cekur më lartë është adekuat dhe ne si gjykatë jemi plotësisht të bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit në raport me të pandehurin por edhe në raport me personat e tjerë, që në të ardhmen të përmbahen nga sjelljet që cenojnë rendin dhe ligjin.

Sa i përket dënimit me gjobë në këtë rast për të pandehurin gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marr parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tij.

-Shpenzimet e procedurës

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.1 dhe 2.6 dhe nenit 453 par.1 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet për ekspertë dhe të paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

2019:173185

Nga ajo që u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.715/20, datë 22.02.2021

Bashkëpunëtore Profesionale,
Kristina Shtufi

Kryetar i trupit gjykues - gjyqtari,
Kushtrim Shyti

KËSHILLË JURIDIKE:Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditës, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykata në kopje të mjaftueshme për gjykatën.

2019:173185